



## In medias res

### Llojet e komunikimit me adoleshentë

*“Ai i cili mundohet t’i imponojë argumentet e tij përmes zërit dhe komandës, tregon që arsyet e tij janë të dobëta”*

Michel Eyquem De Montaigne

Shpeshherë, edhe neve të rriturve na ndodh, që nga dëshira e madhe për ti pasur fëmijët tonë çdo herë afër vetes, bëjmë gabime duke i kritikuar ata vazhdimisht dhe duke argumentuar gjërat përmes zërit dhe komandës. Dhe, çdo herë mendojmë se ne, të rriturit kemi të drejtë. Asnjëherë nuk themi para fëmijëve tanë se edhe ne gabojmë dhe nuk mendojmë se argumentet tona ndonjëherë janë të kota për fëmijët tanë.

Është e zakonshme që adoleshentët të kenë vështirësi për të biseduar lirë. Kjo veti e tyre, për të rriturit është çdo herë frustruese dhe na bën të ndihemi të padobishëm apo të refuzuar.

Heshtja e fëmijës adoleshent është normale. Andaj, të rriturit heshtjen e tyre duhet ta pranojnë qetë dhe me durim.

Mënyra se si të rriturit komunikojnë me fëmijë, ndikon shumë në personalitetin e tyre.

Asnjëherë nuk duhet përqeshur apo poshtëruar mendimin e fëmijës. Asnjëherë nuk duhet qenë agresiv apo ngacmues. Asnjëherë nuk duhet qenë kritik apo gjykues i mendimit. Çdo herë duhet qenë të qetë, të krijojmë atmosferë të përshtatshme për bisedë dhe të mundohemi që fëmijët të fitojnë besimin tonë.

Vështirësitë për komunikim me adoleshentë janë të shpeshta. Nuk është lehtë për një të rritur të bisedojë me një fëmijë-adoleshentë. Është shumë shqetësuese dhe e vështirë të dëgjosh dhimbjet e një fëmije.

Shumë prej fëmijëve nuk janë mësuar të flasin me të rriturit lidhur me atë se si ndjehen. Duhet pasur kujdes në zgjedhjen e personave të cilët mund të komunikojnë me këtë lloj të fëmijëve.

Shumë fëmijë-adoleshentë nuk kanë qenë asnjëherë të inkurajuar të flasin për veten, kështu që atyre u duhet më së shumti ndihmë. Ata mund të jenë të frikësuar se do të dërmohen ndjenjat e tyre dhe dëshirojnë ti mbajnë ndjenjat nën kontroll.

Ka fëmijë të cilëve u mungon besimi. Ata janë fëmijë të cilët jetojnë në fatkeqësi dhe që shpesh kanë arsye për dyshime. Ata mund të jenë të frikësuar nga informuesi apo tradhtia që paragjykojnë se mund të iu bëhet nga një i rritur.

Andaj, para se të fillojmë komunikimin me fëmijë, së pari duhet të mundohemi ta kontrollojmë ngjyrën e zërit tonë dhe të mundohemi që të gjitha argumentet tona të kenë arsye të forta dhe bindëse për fëmijët tanë.

*Shkroi: Ardita Kabashi-Hima*

## Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

### Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Më 27-28 gusht 2007 në lokalet e KEC është mbajtur seminari i dytë “Zhvillimi kognitiv i fëmijëve” në kuadër të Programit të MKLSH-së. Ky seminar është vazhdim i seminarit të parë të mbajtur gjatë muajit qershor. Në këtë seminar morën pjesë 36 mësime të shkollave të ndryshme të Prishtinës. I njëjti seminar është mbajtur më 30-31 gusht në 9 qendra të Kosovës: 2 grupe në Prizren, ndërsa nga një grup në Gjakovë, Klinë, Mitrovicë, Gjilan, Suharekë, në Drenas dhe në Sh. f. “M. Bajraktari” në Prishtinë.



■ Gjatë 29-31 gusht në lokalet e Qendrës Didaktike në Gjakovë është mbajtur seminari i 3 & 4 në kuadër të MKLSH-së për mësime të shkollave “M. Këpuska” dhe “F. Agani” të Gjakovës. Modulet që u zhvilluan gjatë këtij seminari ishin: Leximi, shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë, si dhe Teknika tjera për zhvillimin e të menduarit kritik. Seminari u mbajt në një atmosferë jashtëzakonisht të mirë pune.

### Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin

■ Gjatë javës së parë të korrikut, në kuadër të projektit “Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin” ka vazhduar implementimi i “Javës së luftës së korrupsionit” në Gjilan, Ferizaj dhe Prishtinë. Gjatë kësaj kohe janë transmetuar dy programe nga 1- orë në Radio Gjilani dhe Radio Ferizaj. Gjithashtu është organizuar një tryezë e rrumbullakët në Ferizaj. Ndihej rreth sensibilizimit të opinionit për fillimin e “Javës së luftës së korrupsionit” në Ferizaj, ka dhënë edhe TV Liria.

### Edukimi për të Drejtat e Fëmijës

■ Më 27 dhe 29 gusht, me kërkesën e drejtoreshës së shkollës jopublike “Mileniumi i Tretë”, është mbajtur trajnimi për mësime të shkollës së cilës do ta zhvillojnë gjatë tërë vitit. Pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, ata do të certifikohen si këshilltarë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.



## Edukimi Multikulturor dhe Multietnik

■ Trajnimi i mësimdhënësve në kuadër këtij programi do të filloj në muajin shtator. Deri më tani janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme. Më 31 gusht është mbajtur takimi me trajnerët e këtij programi, të cilët kanë marrë udhëzimet e fundit për organizmin e trajnimeve, gjithashtu, janë pajisur edhe me materialet e trajnimit.



Gjithashtu, gjatë këtij takimi janë caktuar datat e trajnimit, janë ndarë grupet dhe janë zgjedhur disa nga aktivitetet sociale të cilat do ti bëjnë këta trajnerë në kuadër të programit "Edukimi Multietnik dhe Multikulturor".

Përgatitja e manualit është në përfundim e sipër. Në gjuhën turke dhe boshnjake manuali është i gatshëm për përdorim.

## Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit gusht respektivisht nga data 23 deri me datën 25 u mbajtën dy trajnime për klasën e dytë.

Të dy trajnimet ishin vazhdimësi e grupeve të formuara nga regjioni i Podujevës dhe i Mitrovicës.

Në trajnimin ku përfshiheshin pjesëmarrës nga regjioni i Podujevës

morën pjesë 31 pjesëmarrës, ndërsa në atë të Mitrovicës 25 pjesëmarrës.

Trajnimi ka shkuar shumë mirë, të gjithë pjesëmarrësit janë ndarë të kënaqur. Këto dy grupe do të vazhdojnë me trajnimet e radhës, të cilat pritet të mbahen në muajt e ardhshëm.

■ Se shpejti do te mbahen edhe trajnimet me metodologjinë Hap pas Hapi për klasën e III dhe IV.

## Edukimi për të drejtën shoqërore

■ Gjatë muajit korrik, përkatësisht me datat 3, 4, 5 dhe 10, 11, 12, në Mitrovicë dhe Gjakovë është mbajtur trajnimi treditor Edukimi për të Drejtën Shoqërore, organizuar nga Qendra për Arsim e Kosovës.

Në këtë trajnim morën pjesë mësimdhënës të arsimit fillor dhe të mesëm nga këto regjione, përfaqësues të shoqërisë civile, studentë etj.



Pjesëmarrësve iu është prezantuar Moduli i parë, i cili ka si synim ngritjen e njohurive për paragjykimet, stereotipet, shtypjet dhe format e shtypjes, mënyrën e krijimit të tyre si dhe strategjitë për ndryshim të qëndrimeve dhe sjelljeve, të cilat janë krijuar ndaj individëve dhe grupeve tjera.

■ Programi “Edukimi për të Drejtën shoqërore” i financuar nga Banka Botërore është duke u zhvilluar sipas dinamikës së projektit.

Gjatë muajit korrik dhe gusht janë mbajtur edhe dy seminare të tjera tre-ditore, njëri në Ferizaj dhe tjetri në Lipjan. Mendojmë që edhe një grup tjetër të organizohet në kuadër të këtij programi.

Gjatë muajit shtator do të bëhet edhe monitorimi i shkollave të cilat janë të lidhura me projektin dhe do të caktohen aktivitetet sociale nëpër ato shkolla.

përfaqësojnë të drejtat e këtyre komuniteteve në Evropë dhe në Rajon.

“Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim 2007-2017” paraqet një dokument kompakt që reflekton përkushtimin e Qeverisë për arsimimin e pjesëtarëve të të tri komuniteteve, dhe është në harmoni të plotë me dokumente ekzistuese strategjike të sektorit të arsimit.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*

## **Strategjia për integrimin e komuniteteve RAE në arsim 2007-2017**

■ Prej 13-15 korrik u mbajt në Strugë punëtorja përfundimtare që kishte për qëllim finalizimin e dokumentit “Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim 2007-2017”. Hartimi i këtij dokumenti është pjesë e një procesi më të gjerë për hartimin e strategjisë nacionale për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë që zhvillohet nga Qeveria e Kosovës, ndërsa ndihmohet financiarisht nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Vet procesi i hartimit të komponentës së edukimit u sponsorizua nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), dhe u koordinua nga Qendra për Arsim të Kosovës (KEC). Procesi i filluar në dhjetorin e vitit 2007 u karakterizua me pjesëmarrje të gjerë të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, të pjesëtarëve të të tri komuniteteve, të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, të shoqërisë civile, të ekspertëve dhe të organizatave që